



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 154

Tiranë – E martë, 5 tetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 182, datë 10.9.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2021..... 14545
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 183, datë 10.9.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., për transferimin e aseteve..... 14546
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 184, datë 10.9.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave..... 14546
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 185, datë 10.9.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003..... 14547
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 186, datë 10.9.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014.... 14549
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 187, datë 10.9.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 85, seria PV09K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Pure Energy Stebleva” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 19.8.2009..... 14551
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 188, datë 10.9.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selishtë” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011..... 14553
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 189, datë 10.9.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 7, seria PV03P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Sarolli” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 27.8.2003 14555

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 190, datë 10.9.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës e nr. 248, seria PV14K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hidropowerplant Construction” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 6.10.2014, të ndryshuar.....	14557
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 191, datë 10.9.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 253, seria T14P, për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hidropowerplant Construction” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 102, datë 7.11.2014, të ndryshuar.....	14559
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 192, datë 10.9.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 360, seria T17, për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 37, datë 6.3.2017, të ndryshuar.....	14561
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 193, datë 10.9.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë “C.G.C” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017.....	14563



VENDIM
Nr. 182, datë 10.9.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN GUSHT 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 118/5 prot., datë 9.9.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2021”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), me shkresën e saj nr. 7654 prot., datë 3.9.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë

elektrike, për muajin gusht 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”, është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit për vitin 2021”, është 1.5 lekë/kWh.

- Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021 është 7.448 lekë/kWh, bazuar në vendimin nr. 16, datë 20.1.2021.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Gusht 2021

Gusht 2021		Aplikimi FSHU sh.a.	Përlllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	10.667
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.19</u>
Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante		Leke/kWh	10.86
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	15.03

- Për sa përcaktohet për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a.), si dhe të

vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2021, të jetë 15.03 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 15.03 lekësh/kwh, për muajin gusht 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 183, datë 10.9.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“ENERGY PLUS” SHPK, PËR
TRANSFERIMIN E ASETEVE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, pika “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; pikat 1.3 dhe 1.6, të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/2 prot., datë 3.9.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., për transferimin e aseteve”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 839 prot., datë 21.7.2021, ka paraqitur kërkesën për transferimin e aseteve.

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 112, seria PV10K, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe licencës nr. 113, seria T10P, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Faqe | 14546

- Kërkesa e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. nuk është shoqëruar me asnjë dokumentacion, sipas legjislacionit në fuqi, çka bën të pamundur marrjen e saj në shqyrtim nga ERE.

- Për nevoja të aplikimit për transferim asetesh, nga ana e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. bashkëlidhur kërkesës duhet të përcillet edhe i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga neni 7, i “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve të të licencuarve”, si dhe vlera e aseteve fikse që kërkon të transferojë, duke qenë se ERE, në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, shprehet vetëm për asetet fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. për transferim të aseteve.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 184, datë 10.9.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“ENERGY PLUS” SHPK, PËR DHËNIEN
E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
NDRYSHIMIN E ORTAKUT KRYESOR
TË SAJ, NËPËRMJET SHITJES SË 100%
TË KUOTAVE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neni 67, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 15, të “Rregullores



për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.2, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike”; pikës 5.2, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/3 prot., datë 7.9.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k., me NUIS K91928002U, është mbajtëse e licencës nr. 112, seria PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 110, datë 22.12.2010, të ndryshuar, si dhe licencës nr. 113, seria T10P, për tregtimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 22.10.2010.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 838 prot., datë 21.7.2021, shoqëria ka kërkuar nga ERE autorizimin për transferimin e kuotave që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

- Më tej, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 838/2 prot., datë 18.8.2021 dhe nr. 838/4 prot., datë 30.8.2021, shoqëria ka depozituar në ERE sqarime dhe dokumentacion shtesë.

- Kërkesa e shoqërisë vjen në zbatim të pikës 6.2, të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike dhe pikës 5.2, të kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike, ku përcaktohet si vijon:

Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose nëse aksionari/ortaku që kontrollon interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

- Shoqëria ka paraqitur dokumentacion të nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut kryesor.

- Për sa i përket miratimit të autoritetit kontraktor për këtë transferim, shoqëria ka informuar se paralelisht me kërkesën drejtuar ERE-s, i është drejtuar dhe autoritetit kontraktor për

marrijen e miratimit për transferimin e kuotave dhe sapo të pajiset me këtë miratim, do ta vendosë në dispozicion të ERE-s. Për këtë ka vendosur bashkëlidhur shkresën nr. 0709/2254 prot., datë 21.7.2021, drejtuar MIE-s, me anë të së cilës ka kërkuar miratimin për transferimin e 100% të kuotave.

- Në këto rrethana dhe në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në nenin 67, të Kodit të Procedurave Administrative, u pa e arsyeshme që të shtyhet me 30 ditë vendimarrja e Bordit të ERE-s, me qëllim vendosjen e komunikimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe marrjen e informacionit përkatës për fazën në të cilën ndodhet dhënia e miratimit për këtë transferim nga MIE, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1 Shtyrjen me 30 ditë të vendimarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 185, datë 10.9.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS NR. 11, SERIA
PV03K, PËR VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË
“SPAHIU GJANÇ” SHPK, ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 20,
DATË 19.12.2003**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “ç”, dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5,



germa “ç”, dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 3.6, pikës 4.4 dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të 10.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/1 prot., datë 1.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1226/6 prot., datë 27.11.2020. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 680/11 prot., datë 19.5.2021.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 50, datë 21.7.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar si dhe vjeljen e debive të akumuluar.

- Shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/29 prot., datë 28.7.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me

statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “Spahiu Gjanç” sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:

- Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në nenin 107, parashikon se për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42, parashikon se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që



mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

“Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile”.

- Në pikën 4.4, të Kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike parashikohet, se: “I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin”.

- Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, është përcaktuar se efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt, për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 186, datë 10.9.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 224, SERIA T14P, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “SPAHIU GJANÇ” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 14, DATË 3.3.2014

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “ç”, dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç”, dhe neneve 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 3.8, pikës 4.5 dhe pikës 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr.



118/1 prot., datë 1.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s, për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014, për një afat 20-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1226/6 prot., datë 27.11.2020. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 680/11 prot., datë 19.5.2021.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 50, datë 21.7.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debite të akumuluar.

- Shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/29 prot., datë 28.7.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “Spahiu Gjanç” sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime, dhe as dokumentacion për sa kërkohet.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:

- Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në nenin 107, parashikon, se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42, parashikon, se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të



gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

“Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile”.

- Në pikën 4.5, të kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike parashikohet, se: “I licencuari do ta informojë dhe sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit”.

- Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, është përcaktuar se efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe të njofimeve të përsëritura të dërguara për dijeni nga ERE, siç edhe citohet më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njofimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 187, datë 10.9.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS NR. 85, SERIA
PV09K, PËR VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË
“PURE ENERGY STEBLEVA” SHPK, ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 61, DATË 19.8.2009**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “ç”, dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç”, dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 3.6, pikës 4.4 dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/1 prot., datë 1.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitorë ndaj ERE-s, për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

kaonstatoi se:

- Shoqëria “Pure Energy Stebleva” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 85, seria PV09K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 19.8.2009, për një afat 30-vjeçar.



- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1226/10 prot., datë 27.11.2020. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 680/30 prot., datë 19.5.2021.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 50, datë 21.7.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar si dhe vjeljen e debive të akumuluar.

- Shoqërisë “Pure Energy Stebleva” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/23 prot., datë 28.7.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerëson se mund t’i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “Pure Energy Stebleva” sh.p.k, nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:

- Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në nenin 107, parashikon, se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën

e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj; dhe në germën “ç”, të nenit 42, parashikon, se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe ne bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon, se:

Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijëni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.



- Në pikën 4.4, të kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike parashikohet, se: “I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.

- Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, është përcaktuar se efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 85, seria PV09K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Pure Energy stebleva” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 19.8.2009.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 188, datë 10.9.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 129, SERIA PV11K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “SELISHTË” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 60, DATË 22.6.2011

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “ç”, dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç”, dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 3.6, pikës 4.4 dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të 10.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/1 prot., datë 1.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Selishtë” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1226/33 prot., datë 27.11.2020. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 680/13 prot., datë 19.5.2021.



- Me urdhrin e kryetarit nr. 50, datë 21.7.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar si dhe vjeljen e debive të akumuluar.

- Shoqërisë “Selishtë” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/26 prot., datë 28.7.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “Selishtë” sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkohet.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:

- Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107, parashikon, se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditorë për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç” të nenit 42 parashikon, se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të

aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative, që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon, se:

Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijëni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107 të ligjit 43/2015, i cili përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

- Në pikën 4.4, të kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike parashikohet, se: I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.

- Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, është përcaktuar se efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e



këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara, përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni nga ERE, siç edhe citohet më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selishtë” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 189, datë 10.9.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 7, SERIA PV03P, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “SAROLLI” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 15, DATË 27.8.2003

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “ç”, dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç”, dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.201, si dhe pikës 3.6, pikës 4.4 dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/1 prot., datë 1.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sarolli” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 7, seria PV03P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 27.8.2003, të ndryshuar, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1226/65 prot., datë 27.11.2020.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2020, “Mbi korrigjimin e pagesave rregullatore për vitin 2020, për disa nga të



licencuarit e sektorit të energjisë”, është bërë një korrigjim i pagesës rregullatore të këtij subjekti për licencën e prodhimit të energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 258/2020 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 7, datë 15.1.2021. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 115 prot., datë 26.1.2021.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 50, datë 21.7.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe të rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar si dhe vjeljen e debive të akumuluar.

- Shoqërisë “Sarolli” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/25 prot., datë 28.7.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE, çdo dokument që vlerësonte se mund t’i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “Sarolli” sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:

- Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në nenin 107, parashikon, se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditorë për çdo ditë vonesë në pagesën e saj; dhe në germën “ç”, të nenit 42, parashikon, se: ERE heq një licencë, kur i licencuari nuk kryen pagesat e

rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020), që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative, që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon, se:

Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dëni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

- Në pikën 4.4, të kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike parashikohet, se: I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje



të katër kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti, kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.

- Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, është përcaktuar se efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 7, seria PV03P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Sarolli” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 27.8.2003.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 190, datë 10.9.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS E NR. 248, SERIA
PV14K, PËR VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË
“HIDROPOWERPLANT
CONSTRUCTION” SHPK, ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 94, DATË 6.10.2014, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “ç”, dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç” dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 3.6, pikës 4.4 dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/1 prot., datë 1.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 248, seria PV14K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 6.10.2014, të ndryshuar, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1226/81 prot., datë 27.11.2020.



- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2020, “Mbi korrigjimin e pagesave rregullatore për vitin 2020 për disa nga të licencuarit e sektorit të energjisë”, është bërë një korrigjim i pagesës rregullatore të këtij subjekti për licencën e prodhimit të energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 258/2020 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 7, datë 15.1.2021. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 114 prot., datë 26.1.2021.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 50, datë 21.7.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluar.

- Shoqërisë “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/26 prot., datë 28.7.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkohet.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:

- Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107, parashikon, se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros

ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj; dhe në germën “ç”, të nenit 42, parashikon, se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon, se:

Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës, duhet që me marrjen dijëni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.



- Në pikën 4.4, të kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike parashikohet, se: I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.

- Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, është përcaktuar se efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 248, seria PV14K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hidropowerplant Construction” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 6.10.2014, të ndryshuar.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 191, datë 10.9.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 253, SERIA T14P, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “HIDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 102, DATË 7.11.2014, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “ç” dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç” dhe neneve 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe pikës 3.8, pikës 4.5 dhe pikës 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/1 prot., datë 1.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 253, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 102, datë 7.11.2014, të ndryshuar, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1226/81 prot., datë 27.11.2020. I është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 680/19 prot., datë 19.5.2021.



- Me urdhrin e kryetarit nr. 50, datë 21.7.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluar.

- Shoqërisë “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/19 prot., datë 28.7.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t’i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “Hidropowerplant Construction” sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkohet.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:

- Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit, brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditorë për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42, parashikon, se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të

aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon, se:

Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijani, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, i cili përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

- Në pikën 4.5 të kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike parashikohet, se: I licencuari do ta informojë dhe do ta sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

- Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, është përcaktuar se efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës



së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara, përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni nga ERE, siç edhe citohet më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 253, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hidropowerplant Construction” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 102, datë 7.11.2014, të ndryshuar.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 192, datë 10.9.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS NR. 360, SERIA
T17, PËR VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË
“BALKAN ENERGY TRADE” SHPK, ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.
37, DATË 6.3.2017, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42, pika 1, germa “ç”, nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç”, dhe neneve 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 3.6.4, germa “a”, pikës 3.8, pikës 4.5 dhe pikës 5.1, germa “ç”, të kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/1 prot., datë 1.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 360, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 37, datë 6.3.2017, të ndryshuar, për një afat 5-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1231/8 prot., datë 27.11.2020. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 680/37 prot., datë 19.5.2021.



- Me urdhrin e kryetarit nr. 50, datë 21.7.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe të rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar si dhe vjeljen e debive të akumuluar.

- Shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/19 prot., datë 28.7.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t’i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim rezultoi, se subjekti “Balkan Energy Trade” sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkohet.

- Po ashtu, ka rezultuar se shkresat dërguar shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. janë kthyer mbrapsht nga posta, çka e vendos këtë subjekt në shkelje të përcaktimeve të pikës 3.6.4, germa “a”, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ku është parashikuar detyrimi i të licencuarve për të njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të adresës.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen, si vijon:

- mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020;

- mosnjoftimin në afat të ndryshimit të adresës.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107, parashikon, se për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj; dhe në

germën “ç”, të nenit 42, parashikon, se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17, i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon, se:

“Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijani, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile”.

- Në pikën 4.5 të kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike parashikohet, se: “I



Licencuari do ta informoje dhe sqaroje ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit”.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe ERE ka nisur njoftime të përsëritura, siç edhe citohet më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 360, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 37, datë 6.8.2017, të ndryshuar.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 193, datë 10.9.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 369, SERIA TGN17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR, DHËNË SHOQËRISË “C.G.C” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 73, DATË 16.5.2017

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 22 dhe 27, pika 1, germa “ç” dhe nenit 106, pika “a”, “xi”, si dhe pika 1, germa “ç”, “ii”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të

ndryshuar; nenit 5, germa “ç”; neneve 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe nenit 4, pika 8, germa “a”, nenit 6, nenit 7, pika 5 dhe nenit 9, pika 1, germa “d”, të “Kushteve të licencës për tregtimin e gazit natyror”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/1 prot., datë 1.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2020”,

konstatoi se:

- Shoqëria “C.G.C” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2020 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1226/26 prot., datë 27.11.2020. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 680/38 prot., datë 19.5.2021.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 50, datë 21.7.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2020 të pashlyera ndaj ERE-s”, u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, për minimizimin e dëmit të shkaktuar si dhe vjeljen e debive të akumuluar.

- Shoqërisë “C.G.C” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 851/5 prot., datë 28.7.2021, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të



japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2020. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkua që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “C.G.C” sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Po ashtu, ka rezultuar se shkresat dërguar shoqërisë “C.G.C” sh.p.k janë kthyer mbrapsht nga posta, çka e vendos këtë subjekt në shkelje të nenit 4, pika 8, germa “a”, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, ku është parashikuar detyrimi i të licencuarve për të njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të adresës.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:

- Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2020.

- Mosnjoftimin në afat të ndryshimit të adresës.

- Ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, në nenin 106, pika 1, germa “a”, “xi”, si dhe pika 1, germa “ç”, “ii”, parashikon se ERE ndëshkon me gjobë nga 0.1 deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj; dhe në nenin 27, pika 1, germa “ç”, parashikon se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë mund të aplikohet vetëm për disa prej subjekteve debitore të vitit 2020, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e

për këtë arsye, në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2020), që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

“Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile”.

- Në nenin 7, pika 5, të kushteve të licencës së tregtimit të gazit natyror parashikohet, se: “I licencuari do ta informojë dhe do ta sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo me vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit”.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit, është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2020, por edhe ERE ka nisur njoftime të përsëritura, siç edhe citohet më sipër.



Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë “C.G.C.” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë